



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency



UDHËZUES PRAKTIK

nga fusha e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit

Luftimi i Korrupsionit
Parandalimi i Korrupsionit
Deklarimi i Pasurisë
Konflikti i Interesit

Prishtinë
Mars 2015

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit
Lista e Shkurtesave të përdorura
Qëllimi
Kompetencat e Agjencisë
Mënyra e komunikimit
Hapja e rasteve
Evidentimi i rastit të paraqitur

Kapitulli I

HETIMI I KORRUPSIONIT

Veprat penale të cilat ka kompetencë t'i hetojë Agjencia kundër Korrupsionit
Kohëzgjatja e hetimeve për vepra penale me natyrë të korrupsionit
Trajtimi i rasteve
Informata të përgjithshme

Kapitulli II

DEKLARIMI I PASURISË

Zyrtarët e lartë publik të cilët kanë për obligim të deklarojnë pasurinë
Llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë
Çfarë përfshihet në deklarim?
Zyrtari kontaktues:
Procedura e pranimit të Formularëve:
Kontrolli
Përfundimi i kontrollit
Sanksionet për mos deklarim ose deklarim të rrejshëm të pasurisë
Informata të përgjithshme

Kapitulli III

DEKLARIMI I DHURATAVE

Ndalesat për zyrtarët
Llojet e dhuratave
Personat që deklarojnë dhuratat
Regjistrimi i dhuratave të pranuar
Sanksionet për mos deklarim të dhuratave
Informata të përgjithshme

Kapitulli IV

KONFLIKTI I INTERESIT

Nocioni i konfliktit të interesit

Zyrtarët e lartë publik ndaj të cilëve zbatohet LPKI

Veprimet e lejuara për zyrtarin e lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik

Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik

Papajtueshmëria në ushtrimin e funksionit publik

Kufizimet e vëna për zyrtarët e lartë publik në ushtrimin e funksioneve tjera krahas funksionit parësor

Deklarimi i interesave private nga zyrtari i lartë publik

Bartja e drejtimit të ndërmarrjes

Hapat për parandalimin e konfliktit të interesit

Procedura e trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit

Vendimet në lidhje me konfliktin e interesit

Sanksionet për konflikt të interesit (sipas LPKI)

Sanksionet për konflikt të interesit (sipas KP)

Kapitulli V

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK

Informata të përgjithshme

Lista e shkurtesave të përdorura

Agjencia	-	Agjencia kundër Korrupsionit;
Komisioni	-	Komisioni Parlamentar Mbikëqyrës i Agjencisë, sipas nenit të 13 dhe 14 të LAKK.
Konflikti i interesit	-	Gjendje e përcaktuar sikur në nenin 6 të LPKI.
KP	-	Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës.
KRPP	-	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
Kushtetuta	-	Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
Kuvendi	-	Kuvendi i Republikës së Kosovës.
LAKK	-	Ligji nr. 03/L-059 për Agjencinë kundër Korrupsionit.
LDPDh	-	Ligji 04/L-050 për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave.
LNPeLDPDh	-	Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.
LPKI	-	Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
Person zyrtar	-	Personat në kuptim të nenit 120 (paragrafi 2) të KP.
Rregullorja e Punës	-	Rregullorja nr. 01/2014 e Punës e Agjencisë.
Zyrtari i lartë publik	-	Personat në kuptim të nenit 4 të LPKI dhe nenin 3 të LDPDh.



Fjala e Drejtorit

Të nderuar,

Ky udhëzues është një përpjekje e Agjencisë kundër korrupsionit në ofrimin e të dhënave bazike për legjislacionin kundër korrupsionit, një udhëzues për mandatin e Agjencisë një udhërrëfyes për zyrtarët e lartë publik dhe një udhëzues për të gjithë ata që kanë vullnetin, kurajën dhe guximin qytetar që të bëhen pjesë e angazhimit kundër korrupsionit.

Agjencia kundër Korrupsionit është e përkushtuar në realizimin e misionit të saj fisnik. Që nga funksionalizimi i saj keqpërdorimi i detyrës zyrtare, keqpërdorimi i parasë publike dhe keqpërdorimet tjera të besimit dhe të pasurisë publike janë nën shënjestrën e vazhdueshme të zyrtarëve të Agjencisë. I gjithë stafi i Agjencisë është i vetëdijshëm se angazhimi në luftimin e të gjitha dukurive negative është prioriteti dhe reflektimi më i fuqishëm i patriotizmit shtetëror.

Do të doja të kërkoja nga të gjithë që të jemi së bashku në këtë angazhim, të reflektojmë për sakrificat e të gjithë atyre që dhanë çdo gjë për lirin tonë, të mos i harrojmë zotimet tona se pas fitimit të lirisë nuk do ta ndalim rrugëtimin drejt formimit të shtetit dhe të institucioneve tona të mirëfillta dhe të pa korruptuara.

Kosova i ka të gjitha institucionet shtetërore, ajo i ka ndërtuar edhe të gjithë mekanizmat kundër korrupsionit, po ashtu ka miratuar legjislacion modern të bazuar në praktikën dhe përvojat e shteteve më të zhvilluara botërore, andaj në praktikë ekziston një bazament i fuqishëm për të gjithë ata që duan të kontribuojnë në jetësimin e tyre.

Ju siguroj se Agjencia do të jetë një partner i sinqertë dhe i sigurt në rrugëtimin e përbashkët, dhe rritja e vazhdueshme e besimit të qytetarëve tek ne është një garanti për këtë.

Së bashku kundër korrupsionit!

Hasan PRETENI,
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Qëllimi

Ky udhëzues ka për qëllim që t'u ofrojë qytetarëve informacione për misionin e Agjencisë, të njoftojë zyrtarët e lartë publik për obligimet që i kanë (gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare) të parapara me ligjet kundër korrupsionit, sidhe të inkurajojë qytetarët dhe zyrtarët për bashkëpunim me Agjencinë.

Poashtu ky udhëzues përmes formatit praktik u jep informacione të mjaftueshëme zyrtarëve të lartë publik për mënyrën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë së tyre, sidhe u jep informacionin e nevojshëm për pasojat ligjore në rast se deklarimi nuk bëhet sipas parimeve të ligjeve kundër korrupsionit.

Kompetencat e Agjencisë

Neni 5 i Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit i jep autorizime dhe kompetenca këtij institucioni që të:

- Inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë Kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në Prokurorinë Publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;
- Bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit;
- Monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit;
- Mbikëqyr dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat e parapara me ligj të veçantë;
- Mbikëqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
- Mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
- Bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;

- Bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
- Merr pjesë dhe ofron këshilla gjatë procesit të hartimit të Kodit të Etikës në sektorin publik dhe privat;
- Ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare;
- Ka të drejtë të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në fazën e vlerësimit dhe në fazat tjera të realizimit të aktiviteteve të prokurimit publik (neni 8, paragrafi 4) i LPKI;
- Ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje tjera nga fushëveprimi i Agjencisë;
- Mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
- Bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin;
- I raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë (6) muaj për punën e Agjencisë. Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.

Mënyra e komunikimit me AKK-në

Çdo qytetar i rëndomtë apo zyrtar publik i cilit është ballafaquar drejtë për së drejti apo ka informacione në lidhje me ndonjë veprim korruptiv rastin mund ta raportoi në Agjenci përmes këtyre formave të komunikimit:

- Drejtpërdrejt me paraqitje në Agjenci (gjatë orarit të punës, nga ora 08:00 - 16:00);
- Me postë në adresën në Rr. Nazim Gafurri, nr. 31 në Prishtinë;
- Me telefon pa pagesë në nr. 0800 - 10 800 (gjatë orarit të punës, nga ora 08:00 - 16:00);
- Përmes ueb faqes zyrtare në: www.akk-ks.org në butonin Raporto Tani;
- Përmes e mail-it në info@akk-ks.org;
- Përmes formave dhe mjeteve të tjera të komunikimit.

Hapja e rasteve

Agjencia fillon rastet sipas:

- Detyrës zyrtare (ex officio);
- Informatave të pranuar nga personat fizik/juridik.

Evidentimi i rastit të paraqitur

Çdo person i cili paraqet rastin drejtpërdrejt në Agjenci, duhet të plotësojë formularin e veçantë i cili përmban këto të dhëna:

- Të dhënat personale të raportuesit të rastit;

- Të dhënat personale të personave ndaj të cilëve kërkohet zhvillimi i procedurës;
- Deklaratën e raportuesit të rastit në bazë të së cilës kërkon fillimin e procedurës së caktuar;
- Listën e dokumenteve të bashkëngjitura formularit të raportimit të rastit dhe nëse raportuesi nuk i ka ato, informatat eventuale se ku mund të gjenden ato;
- Informacionin se a është duke u zhvilluar procedurë e ngjashme në ndonjë organ tjetër, nëse po raportuesi është i obliguar të shënojë emrin e organit;
- Deklarimin nëse raportuesi dëshiron të mbetet konfidencial si dhe të dhëna të tjera sipas vlerësimit për çdo rast konkret.

KAPITULLI I

HETIMI I KORRUPSIONIT

1. Veprat penale të cilat ka kompetencë t'i hetojë Agjencia

Në takimin e përbashkët të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe institucioneve të cilat kanë mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, pjesë e të cilave është edhe Agjencia, të mbajtur më 10-11 maj 2013, është diskutuar dhe vendosur ndarja e veprave penale në grupe të veçanta. Sipas dokumentit të nxjerrë nga ky takim, grupi i veprave penale të korrupsionit të cilat ka përgjegjësi që t'i hetojë Agjencia janë:

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 422 i) i KP;
- Keqpërdorimi i informatës zyrtare (neni 423) i KP;
- Konfliktit të interesit (neni 424) i KP;
- Përvetësimi në detyrë (neni 425) i KP;
- Mashtrimi në detyrë (neni 426) i KP;
- Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 427) i KP;
- Marrja e ryshfetit; neni 428) i KP;
- Dhënia e ryshfetit neni 429) i KP;
- Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (neni 430);
- Ushtrimi i ndikimit (neni 431) i KP;
- Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 432) i KP;
- Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 433) i KP;
- Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 434) i KP;
- Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme 435 i KP;
- Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 436) i KP;
- Mos deklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, (neni 437) i KP;
- Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (neni 290) i KP;

- Lidhja e kontratës së dëmshme (neni 291) i KP;

- Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 316) i KP.

2. Kohëzgjatja e hetimeve për vepra penale me natyrë të korrupsionit

Hetimet për vepra penale me natyrë të korrupsionit zgjasin:

- Deri në 6 muaj si rregull;
- Deri në 12 muaj përjashtimisht, për raste me natyrë më të ndërlikuar.

3. Trajtimi i rasteve

Agjencia në bazë të Rregullores së Punës i trajton rastet dhe e informon palën për vendimin final në lidhje me rastin. Informimi i palës bëhet së pari verbalisht e pastaj edhe me shkrim.

Vendimi final në lidhje me rastin mund të jetë:

- Kallëzim penal;
- Informatë për policinë;
- Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore;
- Mbyllje e rastit në mungesë të provave;
- Mbyllje e rastit në mungesë të kompetencës;
- Mbyllje e rastit për shkak të zhvillimit të procedurës penale.

4. Informata të përgjithshme

- Trajtimi i rastit është i mbyllur për publikun;
- Subjektet që paraqesin raste si dhe ata ndaj të cilëve zhvillohet procedura, nuk kanë të drejtë të paraqiten në Agjenci, përveç me kërkesë të Agjencisë;
- Çdo subjekt i cili vihet në dijeni për çdo informacion gjatë bashkëpunimit me Agjencinë duhet të ruaj atë si sekret zyrtar;
- Materialet e marra nga çdo person për qëllime të hetimit, i kthehen atij pas përfundimit të procedurës;
- Emrat e personave ndaj të cilëve është paraqitur Kallëzim Penal janë të njohura vetëm për Prokurorinë e Shtetit.

KAPITULLI II

DEKLARIMI I PASURISË

5. Zyrtarët e lartë publik të cilët kanë për obligim të deklarojnë pasurinë janë:

- Presidenti i Republikës së Kosovës, anëtarët e Kabinetit të Presidentit, Sekretari si dhe Drejtorët e Departamenteve Profesionale në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të emëruarit nga ai;
- Deputetët e Kuvendit, të gjithë personat e zgjedhur apo të emëruar nga Kuvendi, Kryesia, Kryetari i Kuvendit si dhe Kabineti i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, Zëvendës-Ministrat, Këshilltarët politik, Shefat e kabineteve si dhe të gjithë të emëruarit nga ta;
- Sekretarët e Përgjithshëm të Qeverisë, Kryeshefat e Agjencive apo pozitat e barasvlershme të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër dhe zëvendësit e tyre, Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, Drejtorët regjional të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve të Doganës;
- Auditorët në Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe të gjithë auditorët e brendshëm të institucioneve;
- Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, Kryeshefat, zëvendës-kryeshefat, sekretarët e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe lokal, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër;
- Anëtarët e Bordit, Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Bankës Qendrore;
- Kryetarët e Komunave dhe Zëvendës Kryetarët, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale;
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor;
- Gjyqtarët dhe Prokurorët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Gjykatës Kushtetuese;

- Udhëheqësit e të gjitha Departamenteve, Drejtorive, Drejtorateve apo njësive të barasvlershme, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit Publik në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike;
- Ambasadorët, Konsujt, Zëvendës Konsujt, Sekretarët e Ambasadave apo Konsullatave të Republikës së Kosovës;
- Rektori dhe Prorektorët e Universitetit Publik, anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit Publik, Dekanët dhe Prodekanët, si dhe Sekretari i Universitetit Publik dhe Njësive Akademike;
- Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorët dhe Drejtorët rajonal të Policisë së Kosovës, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Komandanti, Zëvendës Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Drejtori, Zëvendës Drejtori si dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës;
- Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij;
- Kryeinspektorët dhe zëvendës-kryeinspektorët e Inspektorive të nivelit qendror dhe lokal.
- Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- Të gjithë ushtruesit e detyrës në pozitat e lartpërmendura, që ushtrojnë detyrën më gjatë se tre (3) muaj, janë të obliguar të deklarojnë pasurinë.
- Zyrtari i Lartë është i obliguar që të deklarojë pasurinë edhe për anëtarët e familjes që nënkupton bashkëshortët, bashkëshortët jashtëmartesorë, prindërit dhe fëmijët me të cilët jeton në bashkësi familjare.

6. Llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë

- Deklarimi me rastin e marrjes së detyrës [brenda 30 ditësh nga marrja e detyrës];
- Deklarimi i rregullt vjetor [nga 1 - 31 Mars të çdo viti, për vitin paraparak nga 1 janar-31 dhjetor];
- Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni [brenda 30 ditësh nga përfundimi i funksionit].

- Deklarimi sipas kërkesë së Agjencisë [në çdo kohë sipas kërkesës së Agjencisë, deklarimi bëhet brenda 15 ditëve nga adresimi i kërkesës zyrtarit të lartë publik];

7. Çfarë përfshihet në deklaram?

Zyrtarët e lartë publikë janë të obliguar të deklarojnë gjendjen e pasurisë së tyre dhe anëtarëve të familje. Deklarimi përfshinë:

- Funksionet që i ushtron zyrtari lartë publik;
- Paluajtshmëritë;
- Pasuritë e luajtshme në vlerë mbi tremijë (3.000) Euro;
- Zotërimin e aksioneve në shoqëritë tregtare;
- Letrat me vlerë;
- Paratë e gatshme, në llogari rrjedhëse, në depozita dhe në huadhënie në euro ose në valuta tjera të huaja.
- Të drejtat dhe detyrimet financiare ndaj personave fizik dhe juridik.
- Të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale.

Të dhënat e lartpërmendura plotësohen në Formularin për Deklarimin e Pasurisë të cilin e harton Agjencia në pajtim me ligjin. Zyrtari i lartë publik është i obliguar që vet ta plotësojë Formularin për Deklarimin e Pasurisë dhe ta dorëzojë në Agjenci:

- Personalisht;
- Përmes të autorizuarit të tij;
- Përmes postës;
- Përmes postës elektronike (e mailit, të skanuar) dhe
- Mënyrave të tjera të komunikimit.

8. Zyrtari kontaktues:

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat parashihen me LDPDh, institucionet kanë për obligim të caktojnë zyrtarin kontaktues. Zyrtari kontaktues ka këto detyra:

- Përgatitë listat e zyrtarëve të lartë publik të institucionit përkatës dhe ato i dërgon në Agjenci.

- Për çdo ndryshim eventual në këto lista duhet të njoftojë Agjencinë brenda afatit 15 ditor.
- I njofton zyrtarët e lartë publik për obligimet që kanë për deklarimin e pasurisë.
- Merr pjesë në trajnime të cilat i organizon Agjencia;
- Zyrtari kontaktues me rastin e njoftimit të zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë, duhet të ruan çdo dëshmi apo shënim zyrtar i cili vërteton se zyrtarët e lartë publik janë njoftuar me përgjegjësinë e tyre ligjore, e cila në rast mos deklarimi do të shërbente si provë se ai i ka kryer detyrat e tij si dhe
- Kryen edhe detyrat tjera në lidhje me misionin e Agjencisë.

9. Procedura e pranimit të Formularëve:

- Mënyra e pranimit të Formularëve është e paraparë me Rregulloren e Punës;
- Formularët për Deklarimin e Pasurisë regjistrohen në bazën e të dhënave;
- Në bazë të Formularëve përpilohen Regjistrat;¹
- Publikimi i Regjistrave në uebfaqen e Agjencisë bëhet brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të formularit;
- Agjencia publikon edhe emrat e zyrtarëve të lartë publikë të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë.

10. Kontrolli

- Kontrolli paraprak
- Kontrolli i plotë.

Kontrolli paraprak kryhet për çdo formular për të vërtetuar ekzistimin apo jo të gabimeve materiale ose plotësimet e gabuara të formularit.

Kur nga kontrolli paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, apo jo të plota, Agjencia njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e njoftimit, është i detyruar t'i përmirësoj ato.

¹ Regjistri është dokument i cili përmban të dhënat të nxjerra nga Formulari dhe të cilat nuk bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kontrolli i plotës është proces i përbërë nga tërësia e veprimeve të cilat i ndërmerr Agjencia me qëllim të konstatimit të vërtetësisë dhe saktësisë së përmbajtjes së të dhënave të paraqitura në Formularin për Deklarimin e Pasurisë.

Kontrollit të plotë domosdomshëmërisht i nënshtrohen 20 % e formularëve të dorëzuar si dhe formularët e zyrtarëve për të cilat ka dyshime për deklarim të rrejshëm.

Kontrolli i plotë nënkupton edhe:

- Krahasimin e të dhënave ndër vite;
- Krahasimin e të dhënave të deklaruara me të dhënat e mekanizmave tjerë (Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, Agjencisë Kadastrale e Kosovës, Agjencisë së Regjistrimit Civil, Administratës Tatimore, Doganat, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Financave; Njësisë së Inteligjencës Financiare si dhe të institucioneve tjera).
- Kur gjatë kontrollit të plotë zbulohet se deklarimi nuk është i saktë ose burimi i deklaruar nuk identifikohet dhe nuk mbulon pasuritë e deklaruara, Agjencia kërkon nga zyrtari për të dhënë shpjegime dhe argumente përkatëse të cilat paraqiten me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

11. Kontrolli mund të përfundojë me:

- Vendim për mbyllje të rastit, kur nuk ka shkelje ligjore;
- Trajtim për konflikt të interesit;
- Kërkesë për procedurë disiplinore ndaj zyrtarit kontaktues;
- Me bartje në institucionet tjera në mungesë kompetencash;
- Me paraqitje të kallëzimit penal për deklarim të rrejshëm.

12. Sanksionet për mos deklarim ose deklarim të rrejshëm të pasurisë

Sipas legjislacionit në fuqi, mos deklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rremë përbën veprë penale (neni 437) i KP.

- Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.

- Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
- Vlera e padeklaruar e pasurisë, e të ardhurave ose e dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet.

13. Informata të përgjithshme

- Me kërkesë të mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët kanë mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, Agjencia ju ofron edhe të dhëna të tjera që nuk janë publike;
- Edhe pas përfundimit të afateve ligjore për deklarin e pasurisë, Agjencia i pranon dhe i publikon Formularët, duke mos i ndërprerë procedurat tjera ligjore në lidhje me mosrespektimin e afateve;
- Bashkëpunimi i qytetarëve me Agjencinë në lidhje me deklarin e rrejshëm të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik është konfidencial. Të dhënat e raportuesve të rasteve nuk publikohen.

Shtojca nr. 1

Udhëzues për plotësimin e Formularit për Deklarimin e Pasurisë

Vërejtje: Ky është shembull praktik se si duhet të plotësohet Formulari për Deklarimin e Pasurisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Nr. AKK

2	0	1	4	/	1

FORMULAR PËR DEKLARIMIN E PASURISË

Të vihet shenja “X” në katrorin e njërit nga llojet e deklarimit

☒	ME RASTIN E MARRJES SE DETYRËS
☐	DEKLARIMI I RREGULLT VJETOR
☐	DEKLARIMI SIPAS KËRKESËS
☐	DEKLARIMI PAS MBARIMIT APO SHKARKIMIT NGA FUNKSIONI

Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publik të deklarojnë gjendjen e pasurisë së tyre në Agjencinë kundër Korrupsionit.

- Deklarimi me marrjen e detyrës, duhet të bëhet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga data e emërimit (neni 7 i Ligjit nr. 04/L-050), Ushtruesit e detyrës kanë për obligim deklarimin e pasurisë nëse ushtrojnë detyrën më gjatë se tre (3) muaj.
- Deklarimi i rregullt vjetor, duhet të bëhet nga 1 marsi deri më 31 mars të çdo viti kalendarik për vitin Të vihet shenja ✓ në katrorin e njërit nga llojet e deklarimit. paraprak nga 1 janari deri me 31 dhjetor (neni 8 i Ligjit nr. 04/L-050 si dhe neni 4 i Ligjit nr. 04/L-228).
- Deklarimi sipas kërkesës, duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës (neni 9 dhe 15 i Ligjit Nr. 04/L-050).
- Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni, duhet të bëhet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e mbarimit apo shkarkimit (neni 10 i Ligjit nr. 04/L-050).

Formulari duhet të plotësohet në mënyrë elektronike ose me shkrim (me shkronja të mëdha të shtypit).

Nëse hapësira e ndonjë rubrike nuk është e mjaftueshme, kopjoje dhe vazhdoni të plotësoni atë.

Të gjitha rubrikat e formularit duhet të plotësohen, në të kundërtën formulari nuk do të pranohet nga Agjencia.

Të dhënat e deklaruara publikohen në ueb faqen e AKK – së www.akk-ks.org me përjashtim të rubrikave të hijezuara.

Vërejtje: Mos deklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë është vepër penale sipas nenit 437 të Kodit Penal.

TË DHËNAT E ZYRTARIT TË LARTË PUBLIK

Emri:	AGRON		Mbiemri:	AGRONI	
Funksioni:	DEPUTET				
Emri i Institucionit:	KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS				
Adresa e institucionit:	SHESHI “NËNË TEREZA” NR. 01, PRISHTINË				
Data e emërimit apo mbarimit	01.01.2010		Nënshkrimi		
Data e dorëzimit të formularit:	01.01.2015		Këtu firmoset nga deklaruesi		

TË DHËNAT PERSONALE TË DEKLARUESIT

Këto të dhëna janë konfidenciale dhe nuk publikohen

Emri:	AGIM		Emri i prindit:	Ali		Mbiemri:	AGIMI										
Numri personal:	<table border="1"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td> </tr> </table>		0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Statusi martesor:	☒ I/E martuar ☐ I/E pamartuar ☐ Bashkëjetesë		☐ I/E Ve ☐ I/E shkurorëzuar	
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9								
Datëlindja:	01.01.1900		Vendlindja:	PRISHTINË													
Vendbanimi:	PRISHTINË, SHESHI “NËNË TEREZA” NR. 01, PRISHTINË					Tel. në Zyrë:	038 - 111 222										
Tel. Mobil:	044/- 000-111			Adresa elektronike:	Agron.agroni@rks-gov.net												

PËRBËRJA FAMILJARE

Të dhënat për: **Bashkëshortët, bashkëshortët jashtë martesor (Bashkësia faktike jashtëmartesore), prindërit dhe fëmijët me të cilët jeton në bashkësi familjare (Këto të dhëna janë konfidenciale dhe nuk publikohen)**

Emri	Mbiemri	Datëlindja	Numri personal										Lidhja me deklaruesin	Statusi i/e...
AGIM	AGIMI	01.01.1960	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	BABAI	✓ 1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë
AGIME	AGIMI	01.01.1950	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	NENA	✓ 1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë
BLERTA	AGIMI	01.01.1965	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	BASHKËSHORTJA	✓ 1. Martuar 2. Pamartuar

																	3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë
ADELINA	ADELINA	01.01.1965	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	BASHKËSHORTJA JASHTËMARTESORE	1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve ✓ 5. Bashkëjetesë			
ALBINA	AGIMI	01.01.2000	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	VAJZA	1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë			
														1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë			
														1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve			
														1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë			
														1. Martuar 2. Pamartuar 3. Shkurorëzuar 4. I/E ve 5. Bashkëjetesë			

**FUNKSIONET OSE AKTIVITETET E TJERA QË I KRYEN ZYRTARI I LARTË PUBLIK,
KRAHAS FUNKSIONIT DEKLARUES**

Këtu deklarohen/përshkruhen funksionet tjera krahas funksionit deklarues

Emri i institucionit	UNIVERSITETII PRISHTINËS
Adresa e institucionit	RR. XHORXH BUSH, NR. 24, PRISHTINË
Funksioni	PROFESOR
Data e fillimit	01.01.2000

Emri i institucionit	NTP "AGIMI"
Adresa e institucionit	RR. XHORXH BUSH, NR. 24, PRISHTINË
Funksioni	MENAXHER I NDËRMARRJES
Data e fillimit	01.01.2005

PASURITË E PALUAJTSHME

Këtu deklarohen/përshkruhen në detaje të gjitha pasuritë e paluajtshme që posedon deklaruesi dhe anëtarët e familjes së tij, të regjistruara në regjistrin kadastral ose të paregjistruara

Nr.	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja / m ²	Adresa	Prejardhja e pasurisë	Viti i përfitimit	Vlera në Euro	Pronësia e...
1.	BANESË	60.50	ULPIANA, NR. I/1	E BLERË	1990	60,000.00	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor 4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
2.	SHTËPI NË NDËRTIM E SIPËR ME 5 ARI TRUALL	150	LAGJA E RE, NR. 1, MATI 1, PRISHTINË	NGA KURSIMET DHE KREDIA E MARRË NË BANKË	2014	150,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor ✓ 4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
3.	TOKË PUNE	1 HA	MAKOC, PRISHTINË	E TRASHËGUAR NGA GJYSHËRIT	1970	50,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor 4. Prindërit 5. Fëmijëve ✓ 6. Përbashkët
4.	MAL	50 ARI	KOLIQ, PRISHTINË	E BLERË NGA PRINDËRIT	1980	25,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor 4. Prindërit 5. Fëmijëve ✓ 6. Përbashkët
5.							1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor 4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
6.							1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor 4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

PASURITË E LUAJTSHME, MBI TREMIJË (3,000.00) EURO

Këtu deklarohen/përshkruhen të gjitha pasuritë e luajtshme të deklaruesit dhe të anëtarëve të familjes së tij, në vlerë mbi 3,000.00 Euro

Nr.	Lloji i pasurisë	Prejardhja e pasurisë	Viti i përfitimit	Vlera në euro	Pronësia e...	
1.	VETURË AUDI A3	E BLERË	2010	10,000.00	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
2.	PAJISJE BUJQËSORE	E BLERË	1995	20,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve ✓ 6. Përbashkët

3.	VETURË GOLF 4	DHURATË NGA VËLLAI	2005	6,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit ✓ 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
4.	STOLI ARI	E BLERË	2009	7,000.00	1. Deklaruesit ✓ 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
5.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
6.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
7.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

ZOTËRIMI I AKSIONEVE NË SHOQËRI TREGTARE

Këtu deklarohen/përshkruhen bizneset e deklaruesit dhe të anëtarëve të familjes së tij

Nr.	Emri i shoqërisë tregtare	Përqindja e aksioneve	Kapitali në €	Data e përfitimit të aksioneve	Aksionet e...	
1.	NTP “AGIMI”	100 %	100,000.00	2005	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve ✓ 6. Përbashkët
2.	NTP “ARTA”	25 %	30,000.00	2007	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
3.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
4.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
5.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

POSEDIMI I LETRAVE ME VLERË

Këtu deklarohen/përshkruhen letrat me vlerë, të deklaruesit dhe anëtarëve të familjes së tij

Nr.	Letra me vlerë	Vlera e letrës /€	Burimi	Data e pranimit / dhënies	Letra e...	
1.	ÇEK	5,000.00	E BLERË	01.01.2011	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
2.	KAMBIAL	7,000.00	E BLERË	01.01.2011	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es ✓ 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

3.					1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
----	--	--	--	--	--	--

PARA TË GATSHME NË LLOGARI RRJEDHËSE, NË DEPOZITA DHE NË HUADHËNIE NË EURO OSE NË VALUTA TJERA TË HUAJA

Këtu deklarohen përshkruhen të gjitha paratë e gatshme dhe të kursyera që i posedon deklaruesi dhe anëtarët e familjes së tij

Nr.	Emri i institucionit financiar ose personit fizikë	Vendi	Shuma në euro ose valutë tjetër	Zotëruesi	
1.	PROCREDIT BANK	PRISHTINË	10,000.00	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
2.	RAIFFEISEN BANK	PRISHTINË	8,000.00	1. Deklaruesit ✓ 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
3.	NLB PRISHTINA	PRISHTINË	5,000.00	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit ✓ 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
4.				1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
5.				1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
6.				1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

TË DREJTAT DHE DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIK DHE FIZIK

Këtu deklarohen /përshkruhen të gjitha huadhëniet dhe huamarrjet si dhe detyrimet tjera për deklaruesin dhe anëtarët e familjes së tij

Nr.	Të drejtat	Detyrimet	Qëllimi i detyrimit financiar	Kohëzgjatja	Vlera në euro ose valutë tjetër	Detyrimet e...	
1.		TEB BANK	NDËRTIMI I SHTËPISË	2014 - 2024	100,000.00 €	✓ 1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
2.	ALI ALIU		FINANCIMI I STUDIMEVE	2010 - 2015	10,000.00 €	1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit ✓ 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
3.		IMF "FINCA"	BLERJA E VETURËS SË DJALIT	2010 - 2012	5,000.00 €	1. Deklaruesit ✓ 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
4.						1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
5.						1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët
6.						1. Deklaruesit 2. Bashkëshortit/es 3. Bashk. jashtë martesor	4. Prindërit 5. Fëmijëve 6. Përbashkët

TË ARDHURAT PERSONALE PËR VITIN, NGA PAGA OSE PJESMARRJA NË BORDE, KOMISIONE OSE ÇDO VEPRIMTARI TJETËR QË SJELL TË ARDHURA PERSONALE

Këtu deklarohen/përshkruhen të gjitha të hyrat vjetore nga çdo lloj veprimtari që sjell të ardhura për deklartuesin dhe anëtarët e familjes

	Lloji i të hyrave (Neto)	Burimi	Vendi	Banka	Shuma/€
Deklaruesi	PAGË	KUVENDI I KOSOVËS	PRISHTINË	PCB	1,400.00
	KOMPENSIM PËR PUNË NË KOMISIONIN PARLAMENTAR	KUVENDI I KOSOVËS	PRISHTINË	PCB	400.00
	BIZNES FAMILJAR		PRISHTINË	TEB BANK	500.00
	MËDITJE				5,000.00
	HONORAR				300.00
	Totali/€				7,300.00
Bashkëshorti t/es	PAGË	MASHT	PRISHTINË	PCB	400.00
	Totali/€				400.00
Bashk. jashtë martesor					
	Totali/€				
Prindërit	PENSION	MPMS	PRSIHTINË	NLB	140.00
	Totali/€				140.00
Fëmijëve	PAGË	NTP "AGIMI"	PRSIHTINË	BKT	650.00
	Totali/€				650.00

TË DHËNA TË TJERA

Nëse në rubrikat më lartë nuk kanë qenë të përfshira të gjitha informacionet që ju duhet t'i deklaroni apo dëshironi të jepni sqarime shtesë ju mund t'i plotësoni këtu

PASURIA E PALUAJTSHME TOKË PUNE E DEKLARUAR SI E PËRBASHKËT ËSHTË TRASHËGUAR NGA GJYSHËRIT DHE NË TË PËRVEC MEJE, JANË HISEDARË EDHE VËLLEZËRIT DHE MOTRAT.

PO ASHTU, EDHE SHTËPIA E DEKLARUAR NË NDËRTIM E SIPËR ËSHTË KRYER VETËM PJESA E NDËRTIMIT TË VRAZHDË.

Deklaruesi

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

KAPITULLI III

DEKLARIMI I DHURATAVE

14. Ndalesat për zyrtarët

- Personi zyrtar nuk mund të kërkojë ose të pranojë dhurata ose favore të tjera për vete, as për anëtarët e familjes, që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës zyrtare dhe të cilat ndikojnë, ose mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave protokollare dhe dhuratave të rastit
- Personi zyrtar nuk mund të marrë më shumë se një dhuratë në vit nga i njëjti person, apo institucion.
- Personi zyrtar nuk mund të pranojë dhurata monetare, letra me vlerë dhe metale të çmuara, pa marrë parasysh vlerën e tyre.
- Personi zyrtar nuk mund të pranojë dhurata të rastit vlera e përgjithshme e të cilave kalon mbi pesëqind (500) Euro brenda vitit.

15. Llojet e dhuratave

Sipas LDPDh, parashihen këto lloje të dhuratave;

- **Dhuratat protokollare**, [konsiderohen dhuratat e pranuar nga përfaqësuesit e vendeve të huaja, organizatave ndërkombëtare ose institucioneve të huaja gjatë vizitave];
- **Dhuratat e rastit**, [dhuratat e rastit konsiderohen dhuratat e vogla me vlerë deri në njëzetepesë (25) Euro.

16. Personat që deklarojnë dhuratat

Personat zyrtar në kuptim të nenit 120, (paragrafi 2) të KP, i cili përfshinë:

- Personat e zgjedhur ose të emëruar në një organ shtetëror;
- Personat e autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;

- Personat të cilët ushtrojnë detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

17. Regjistrimi i dhuratave të pranuara

Institucionet publike kanë përgjegjësi regjistrimin e dhuratave të pranuara. Regjistrimi i dhuratave bëhet në Katalogun e Dhuratave²:

- Dhuratat e pranuara regjistrohen sipas llojit, vlerës që kanë, emrin e dhënësit të dhuratës;
- Katalogu i Dhuratave mbahet nga institucioni përkatës;
- Kopja e Katalogut të Dhuratave dorëzohet në Agjenci jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim për vitin paraprak.
- Agjencia kontrollon Regjistrat e Dhuratave dhe në rast të konstatimit të devijimeve ju rekomandon institucioneve që t'i përmirësojnë ato.
- Në rast të konstatimit të shkeljeve të dispozitave të LDPDh nga personi zyrtar, kur shkelja nuk përbën vepër penale, Agjencia i kërkon institucionit punëdhënës që të ndërmerr masa disiplinore ndaj tij. Institucionet e informojnë Agjencinë në lidhje me masat e caktuara ndaj personit zyrtar.
- Në rast të konstatimit të veprës penale në lidhje me pranimin e dhuratave, Agjencia paraqet kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit.

18. Sanksionet për mos deklarim të dhuratave

- Sipas legjislacionit në fuqi, mos deklarimi i dhuratave përbën vepër penale (neni 437) i KP.
- Nëse Agjencia konstaton se personi zyrtar i ka shkelur dispozitat e këtij ligji dhe nëse shkelja nuk dyshohet se përbën vepër penale, informon institucionin në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën dhe kërkon që ndaj shkelësit të merren masa disiplinore. Institucioni përkatës duhet ta informojë Agjencinë për masat disiplinore që janë marrë ndaj personit zyrtar.

² Katalogu i Dhuratave i është bashkëngjitur këtij udhëzuesi në fund.

19. Informata të përgjithshme

- Personi zyrtar duhet ta informojë me shkrim eprorin e tij, nëse i është ofruar ose dhënë një dhuratë pa paralajmërim dhe në rrethana specifike. Në rast se personi zyrtar është drejtues institucioni, ai duhet ta informojë Agjencinë;
- Nëse dhurata e rastit nuk është e karakterit personal, ajo menjëherë bëhet pronë e institucionit në të cilën personi zyrtar ushtron detyrën. Dhuratat protokollare bëhen pronë e institucionit në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën.
- Dhuratat protokollare si: simbolet shtetërore, medaljet dhe shenjat protokollare, mund të përdoren gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Shtojca nr. 2

Udhëzues për plotësimin e katalogut të dhuratave

Vërejtje: Ky është shembull praktik se si duhet të plotësohet Formulari për Deklarimin e Pasurisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

**KATALOG I DHURATAVE**

Nr. rendor i dhuratës së pranuar:

01

Institucioni:

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Emri i pranuesit:

FILAN FISTEKU

Funksioni:

DREJTOR I AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Të dhënat e dhënësit të dhuratës:

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE, SHQIPËRI

(Emri, mbiemri dhe funksioni i dhënësit të dhuratës)

Lloji i dhuratës:



Protokollare



E rastit

Përshkrimi i dhuratës:

STEMA E ILDKPI

Vlera e dhuratës:

00 €

Arsyeja e dhënies së dhuratës:

GJATË VIZITËS ZYRTARE NË INSTITUCIONIN HOMOLOG ILDKPI, KAM PRANUAR DHURATË PROTOKOLLARE, STEMËN E ILDKPI, NË SHENJË BASHKËPUNIMI NDËRMJET DY INSTITUCIONEVE.

Datë: 01.01.2010

Nënshkrimi i Zyrtarit pranues: _____

Evidentoi:

Emri & Mbiemri:

ALI ALIU

Datë:

01.01.2010

Nënshkrimi dhe Vula:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY



KATALOG I DHURATAVE

Nr. rendor i dhuratës së pranuar:

02

Institucioni:

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Emri i pranuesit:

FILAN FISTEKU

Funksioni:

DREJTOR I AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Të dhënat e dhënësit të dhuratës:

FILAN FILANI, SHOK I STUDIMEVE

(Emri, mbiemri dhe funksioni i dhënësit të dhuratës)

Lloji i dhuratës:

☐

Protokollare

☒

E rastit

Përshkrimi i
dhuratës:

ORË MURI

Vlera e dhuratës:

20 €

Arsyeja e dhënies së dhuratës:

**GJATË VIZITËZ NË AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT KAM PRANUAR
DHURATË TË RASTIT.**

Datë: **01.01.2010**

Nënshkrimi i Zyrtarit pranues: _____

Evidentoi:

Emri & Mbiemri:

ALI ALIU

Datë:

01.01.2010

Nënshkrimi dhe Vula:

KAPITULLI IV KONFLIKTI I INTERESIT

20. Nocioni i konfliktit të interesit

Konflikti i interesit është çështje e re në teorinë dhe praktikën juridike në Kosovë. Sipas LPKI, konflikti i interesit paraqet gjendjen e mospajtimit ndërmjet detyrës zyrtare dhe interesit privat të zyrtarit publik, kur ekziston interesi privat i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, personal ose pasuror që mund të ndikojë ose ndikon në ligjshmërinë, objektivitetin, transparencën, paanshmërinë e personit zyrtar në ushtrimin e funksionit publik.

21. Zyrtarët e lartë publik ndaj të cilëve zbatohet LPKI

Neni 4 i LPKI.

- Presidenti, anëtarët e Kabinetit të tij, Sekretari dhe Drejtorët e Departamenteve në Zyrën e Presidentit;
- Deputetët e Kuvendit si dhe të gjithë personat e zgjedhur apo të emëruar nga Kuvendi apo Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministri, zëvendës-kryeministrat, ministrat, zëvendës-ministrat, Këshilltarët politik, Shefat e Kabineteve si dhe të gjithë të emëruarit nga ta;
- Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive; dhe ai Zyrës së Kryeministrit; Kryeshefat e Agjencive të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër;
- Drejtori, Zëvendës Drejtori dhe Drejtorët Regjional të Administratës Tatimore të Kosovës; Drejtori i përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve të Doganës;
- Auditorët në Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe të gjithë auditorët e brendshëm të institucioneve;
- Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Anëtarët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike, anëtarët e Bordeve të Rregullatorëve, të Komisioneve apo Agjencive tjera të themeluara me ligj apo me ndonjë akt tjetër;

- Anëtarët e Bordit, Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i Bankës Qendrore;
- Kryetarët dhe Zëvendës Kryetarët e Komunave, Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit, Këshilltarët e Asambleve Komunale si dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale;
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor, anëtarët e Këshillit Prokurorial, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, Auditori Gjyqësor, Prokurori Disiplinor;
- Gjyqtarët dhe Prokurorët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Gjykatës Kushtetuese.
- Drejtorët e të gjitha Departamenteve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit publik në të gjitha institucionet publike.
- Ambasadorët, Konsujt, Zëvendës Konsujt, Sekretarët e Ambasadave apo Konsullatave të Republikës së Kosovës.
- Rektorët dhe Prorektorët e Universiteteve Publike, Dekanët dhe Prodekanët, Sekretarët e Universiteteve Publike dhe Njësive Akademike;
- Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorët dhe Drejtorët rajonal të Policisë së Kosovës, Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës.
- Komandanti, Zëvendës Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës.
- Drejtori, Zëvendës Drejtori si dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.
- Avokati i Popullit dhe Zëvendësit e tij.
- Kryeinspektorët dhe inspektorët e nivelit qendror dhe lokal.
- Të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri si dhe Ministrat, e që nuk përmenden shprehimisht në ligj.

22. Veprimet e lejuara për zyrtarin e lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik

- Të jetë anëtar i organit drejtues të Organizatës Jo Qeveritare nga lëmi i shkencës, kulturës, sportit por pa të drejtë pagese, më [përjashtim të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit], por Organizatat Jo Qeveritare e cila ka në përbërjen e organit drejtues të saj zyrtarin e lartë publik, nuk mund të përfitojë mjete nga Buxheti i Kosovës, nëse ai ka ndikim në vendimmarrje.
- Të ushtrojë funksione politike, me kusht që një gjë e tillë nuk bie në kundërshtim me ndonjë ligj;
- Të merret me veprimtari shkencore, sportive, kulturore dhe humanitare, nëse një gjë e tillë nuk bie në kundërshtim me ndonjë ligj;
- Të realizojë të ardhura në bazë të së drejtës së autorit, patentës e të ngjashme;
- Zyrtari i lartë publik ka të drejtë të informohet për ecurinë e ndërmarrjes ku ka pronësi ose një pjesë të pronësisë dhe të rimarr drejtimin e ndërmarrjes nga personi i besuar pasi të plotësohet kushtet sipas LPKI.

23. Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik

- Të kërkojë apo pranoj shpërblim, premtim shpërblimi lidhur me veprimin e ndërmarrë apo mosveprimin që është i obliguar ta ndërmerr në kuadër të ushtrimit të funksionit publik;
- Të fitojë ndonjë të drejtë, apo të pranoj premtim për fitimin e saj, në rastet kur shkelet parimi i barazisë para ligjit;
- Të kërkojë, përvetësojë, pranojë, shpërblime apo shërbime për vete ose për tjetrin si kompensim të votës së tij në vendimmarrje;
- Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material personal apo personit në lidhje me të;
- Të premtojë punësim apo ndonjë të drejtë tjetër në ndërrim për dhuratë apo dhuratë të premtuar;
- Të ndikojë në marrje - dhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale;

- Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm;
- Të ndikojë në vendimmarrje të organeve legislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit më qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërt apo të besueshëm;
- Të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm;
- Të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik;
- Pas përfundimit të funksionit publik, nuk ka të drejtë për 1 vit të punësohet në pozitë udhëheqëse, në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë 2 vjetëve të fundit sa ka ushtruar funksionin publik kanë qenë të lidhura direkt me mbikëqyrjen ose kontrollin e atyre ndërmarrjeve;
- Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë aktivisht të drejtën e pronësisë në ndërmarrje pavarësisht llojit të veprimtarisë së saj;
- Në çdo rast kur personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet publike, ndërmarrjet publike ose ndërmarrjet private të cilat kanë më shumë se 5 % të kapitalit ose aksioneve publike, duhet të njoftojë zyrtarin e lartë publik;
- Në çdo rast kur vërtetohet se vendimi i marrë është në kundërshtim me vullnetin e lirë të zyrtarit të lartë publik, institucioni duhet të anulojë atë;
- Gjatë kohës së transferimit të të drejtës së drejtimit të ndërmarrjes në personin e besuar, zyrtari i lartë publik nuk ka të drejtë të jap informata, udhëzime, këshilla ose informata për personin e besuar;

24. Papajtueshmëria në ushtrimin e funksionit publik

- Nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private.
- Në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme.

- Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë pune nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.
- Zyrtari i lartë i cili ushtron veprimtari të pavarur në ndërmarrje apo veprimtari tjetër fitimprurës, është i detyruar të veprojë në pajtim me dispozitat e LPKI.
- Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse.

25. Kufizimet e vëna për zyrtarët e lartë publik në ushtrimin e funksioneve tjera krahas funksionit parësor

Zyrtari i lartë publik

- Nuk mund të jenë menaxher ose anëtar i organit menaxhues në organizata fitimprurës dhe jofitimprurës, me përjashtim të subjekteve politike dhe në rastet kur funksioni i tillë i dedikohet për shkak të funksionit;
- Nuk mund të ushtrojë veprimtari private në kuadër të profesioneve të lira, si në avokati, noteri, ndërmjetësim, përmbarrim privat, si konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave.
- Nuk mund të ushtrojë aktivisht të drejtën e pronësisë apo një pjesë të saj në ndërmarrje, pavarësisht nga fushëveprimtaria e saj.

26. Deklarimi i interesave private nga zyrtari i lartë publik

- Zyrtari i lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të deklarojë në çdo rast interesin privat lidhur me vendimmarrjen që mund të ndikojnë në lindjen e konfliktit të interesit. Deklarimin e interesit privat të zyrtarit të lartë publik mund t'ia kërkojë edhe udhëheqësi ose institucioni punëdhënës. Deklarimi si rregull bëhet me shkrim e përjashtimisht edhe me gojë.
- Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së

interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

- Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Vet deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

27. Bartja e drejtimit të ndërmarrjes

Zyrtari i lartë publik (pronari i ndërmarrjes) me rastin e zgjedhjes/emërimit/caktimit në funksionin publik, është i obliguar që:

- Të bartë të drejtën e administrimit, menaxhimit ose drejtimit të ndërmarrjes në personin e besuar, brenda 30 ditësh nga zgjedhja/emërimi i tij kurse brenda 5 ditësh nga bartja të njoftoj Agjencinë me shkrim.
- Personi i besuar vepron në emër dhe në llogari të zyrtarit të lartë publik. Personi i besuar nuk mundet të jetë personi i afërt me Zyrtarin e Lartë.
- Nëse personi i besuar krijon marrëdhënie afariste me institucionet e qeverisjes qendrore, lokale, ndërmarrjet publike apo me ndërmarrjet private ku kapitali i pronës publike ka më shumë se pesë (5) % të kapitalit apo aksioneve, personi i besuar është i detyruar që të njoftoj zyrtarin e lartë lidhur me marrëdhëniet e tilla afariste

28. Hapat për parandalimin e konfliktit të interesit

Zyrtari i lartë publik është i obliguar që të parandaloj çdo rast të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si në vijim:

- Të zgjidh vet konfliktin e interesit;
- Në raste të dyshimit, të konsultohet me udhëheqësin e tij kurse ata që nuk kanë udhëheqës të drejtpërdrejtë, i drejtohen Agjencisë e nëse edhe udhëheqësi ose institucioni udhëheqës ka dyshime në lidhje me ekzistimin e konfliktit të interesit, kërkojnë konsultim nga Agjencia;

29. Procedura e trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit

Procedura e trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit bëhet në pajtim me Rregulloren e Punës.

30. Vendimet në lidhje me konfliktin e interesit mund të jenë:

- Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse;
- Kërkesë për masë disiplinore;
- Kërkesë për shkarkim;
- Kërkesë për fillimin e procedurës ndaj deputetit;
- Opinione;
- Këshilla;
- Vendime.

31. Sanksionet për konflikt të interesit (sipas LPKI)

- Kundërvajtje dënimi me gjobë prej 500 - 2500 Euro;
- **Ndalimi ushtrimit të funksionit publik** në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në 1 vjet.
- Masë disiplinore;
- Shkarkimi nga detyra;
- Anulimi i kontratës si dhe kthimi i përfitimeve të nxjerra nga veprimet joligjore.

32. Sanksionet për konflikt të interesit (sipas KP)

- **Për veprë penale** dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 5 (pesë) vjet (neni 424 i KP).

33. Informata të përgjithshme

- Procedura e trajtimit të konfliktit të interesit është e mbyllur për publikun. Vendimet finale në lidhje me rastet dhe opinionet bëhen publike.
- Në rast të tentimit të ushtrimit të ndikimit, zyrtari i lartë publik duhet të njoftojë me shkrim udhëheqësin apo institucionin e tij që e ka zgjedhur ose emëruar për të shmangur ndikimin, kurse nëse ushtrohet ndikim në zyrtarin e lartë publik në lidhje me vendimmarrjen, përveç udhëheqësit të tij, njoftohet edhe Agjencia, e cila fillon shqyrtimin e rastit;
- Në rast të tentimit të ushtrimit të ndikimit për ndryshimin e vullnetit të zyrtarit të lartë publik, ai duhet të:
 - Refuzojë ofertën;
 - Të përpiqet që të identifikojë ofertuesin;
 - Të dorëzojë dhuratën te udhëheqësi i tij si dhe të njoftojë atë me shkrim sa më shpejt që është e mundur;
 - Të prezantojë dëshmitarët dhe provat për vërtetimin e fakteve në lidhje me rastin.
- **Agjencia në punën e saj për trajtimin e konfliktit të interesit, përveç LPKI bazohet edhe në legjislacionin tjetër në fuqi me të cilin rregullohet çështja e konfliktit të interesit, varësisht natyrës së rastit. Edhe në këto raste procedura e trajtimit të rasteve është e njëjtë.**
- Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (neni 5, paragrafi 1, pika 1. 8 dhe nenin 46);
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (neni 38, 59, 60, 61, 63, 67);
- Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (neni 36);
- Kodi të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike (neni 7);
- Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi (neni 41);
- Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës në Sistemin Shëndetësor (neni 29);
- Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit (neni 17);
- Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (neni 78, paragrafi 5);
- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (neni 69);
- Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet (neni 61);
- Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat (neni 32);
- Ligji nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (neni 7, 39 dhe 44);
- Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (neni 12);
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë (neni 38);
- Ligji nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm (neni 4, paragrafi 1, pika 1.2).

KAPITULLI V

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK

34. Informata të përgjithshme

- Agjencia monitoron aktivitetet e prokurimit publik të publikuara në uebfaqen e KRPP-së.
- Ekzaminon rastet kur dyshon se aktivitetet tenderuese po përgatiten ose po realizohen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Të gjitha institucionet janë të obliguara që të ofrojnë dokumentacionin e kërkuar.
- Procedura e trajtimit të rasteve është e mbyllur për publikun dhe realizohet në pajtim me Rregulloren e Punës.
- Vendimet finale në lidhje me rastet bëhen publike.
- Agjencia merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në fazën e vlerësimit dhe në fazat tjera të realizimit të aktiviteteve të prokurimit.
- Pjesëmarrja në vëzhgim realizohet me kërkesën e udhëheqësve të institucioneve dhe sipas vlerësimit të Agjencisë (ex officio).
- Opinionet e Agjencisë kanë karakter këshillues/rekomandues.
- Agjencia përcjell zbatimin e opinioneve dhe në rastet kur vlerëson se opinionet nuk janë përfillë në mënyrë ligjore, e përcjell rastin për trajtim të mëtejshëm në Departamentin për Luftimin e Korrupsionit në Agjenci.
- Komunikimi (vizitat, telefonatat, sms-ët, e mail) i zyrtarëve të institucioneve lëndët e të cilëve janë objekt i trajtimit nga Agjencia, është i ndaluar. Çdo tentim ndikimi në punën e Agjencisë bëhet publik.

SË BASHKU KUNDËR KORRUPSIONIT

Raporto në: 0800 10 800

00 381 (0) 38 518 907
Rruga "Nazim Gafurri" Nr. 31, Prishtinë, Kosove
info@akk-ks.org
www.akk-ks.org